

LIGJ
Nr. 27/2012

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8626, DATË 22.6.2000 “PËR STATUSIN E INVALIDIT
PARAPLEGJIK DHE TETRAPLEGJIK”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8626, datë 22.6.2000 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 11 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 11

Të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë dhe shoqëruesit e tyre përfitojnë kompensim për shërbimin e transportit. Masa, kriteret dhe procedurat e këtij përfitimi përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 2

Neni 12 ndryshohet dhe riformulohet si më poshtë:

“Neni 12

Të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të cilët kanë përfituar statusin, përfitojnë kompensim të faturës së energjisë elektrike dhe të faturës së telefonisë fikse. Masa, kriteret dhe procedura e përfitimit të këtij kompensimi financiar përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 3

Neni 18 shfuqizohet.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 15.3.2012

Shpallur me dekretin nr. 7371, datë 5.4.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi